



Viti i VII^{-të} i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

KARTAT THEMELORE TË SHTETIT SHQIPTAR DHE RËNDËSIA QË ATO I KANË DHËNË PARIMIT TË LAICIZMIT

Ismail Tafani*, Fatmir Tartale**

*Departamenti i Shkencave Juridike, Albanian University, Albania

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Albania

Adresë kontakti: ismailtafani@yahoo.it

Përmbledhje

Në Deklaratën e Pavarësisë, edhe pse jo në mënyrë eksplicite, shprehet një formë ndarjeje midis shtetit dhe besimit fetar, kjo për të bërë të mundur që shteti i ri të mos kishte influencë osmane nëpërmjet besimit islam.

Statuti Organik i Mbretërisë Shqiptare e parashikoi të shprehur për herë të parë këtë parim, për faktin se gjashtë fuqitë e mëdha i druheshin rrezikut që mund t'i vinte shtetit nga prezenca multifetare në vend.

Në Statutin e zgjeruar të Lushnjës parashikohej, përveç parimit të laicizmit, edhe një lloj ndarjeje mes urdhrin shpirtëror dhe atij shtetëror, frymë kjo, e cila vijoi edhe në statutin e mbretërisë së mbretit të shqiptarëve.

Ndonëse pati një shfuqizim të heshtur me ardhjen e fashizmit, parimi i sekularizmit shfaqet akoma më i heshtur në Shqipërinë komuniste, e cila e ekstremizoi kuptimin e tij deri në një formë ateizmi aktiv shtetëror.

Pas rënies së sistemit komunist, parimi i laicizmit do të ishte bazë për funksionimin e institucioneve post-komuniste, ndonëse problemet social-ekonomike të shqiptarëve nuk do të linin hapësirë për konsolidimin e këtij parimi pas viteve të errëta të ateizmit.

Në kushtetutën e vitit 1998, parimi i laicizmi qëndron në themel të saj, dhe pikërisht tani kur Evropa duket në luftë mes qytetërimeve dhe ku feja duket sikur pretendon primatin në bashkëjetesën multietnike, Shqipëria historikisht multifetare paraqitet një model për t'u ndjekur.

Ky studim ka si objektiv të vështrojë në mënyrë introspektive parimin e sekularizmit në kuadrin e një reflektimi historik për të kuptuar se si laicizmi ka evoluar dhe në të njëjtën kohë duket i njëjtë, se si ka arritur të disiplinojë një shoqëri kaq komplekse si ajo shqiptare, duke e transformuar atë në një laicizëm funksional.

Fjalë çelës: parim i laicizmit, liri e besimit, akt themelor, ateizëm, kushtetutë shqiptare.

FUNDAMENTAL LAWS OF THE ALBANIAN STATE AND THE IMPORTANCE OF THE PRINCIPLE OF LAICISM

Abstract

The separation of state and religion is foreseen in the Independence Declaration in order to avoid the ottoman influence through Islam to the new established state, even though not explicitly.

This principle was first explicitly stated in the Statute of the Albanian Kingdom, owing the fear of six major powers on the potential risk of multi religions in the country.

In the statute of Lushnja was stated along with the laicism, the separation of spiritual order from state authority, influence followed in the Statute of Albanian Kingdom.

The principle of secularism was faded during the period of “fascism” empire and it was eventually inexistent during the communist regime, where secularism was replaced with atheism form of state.

After the fall of the communist regime, the principle of laicism was essential for the functioning of the post-communist institutions, notwithstanding that the consolidation of this principle was indicated by the socio-economic situations of Albanians, following the long period of the atheism domination.

The principle of laicism is fundamental in the Albanian Constitution of 2008 and the multi-religion Albanian is seen as a model to be followed, while religion is somehow dominating in the multi-ethnic Europe, in conflict between civilization and religion.

This study aims at providing an introspective overview of the principle of secularism in the framework of historical reflection, understanding this principle’s evolution, while it appears to be the same and how this principle reflects the discipline of a very complex society as Albanian, transforming it into a functional laicism.

Keywords: Principle of laicism, freedom of religion, fundamental laws, atheism, the Albanian constitution.

1. Një trajtim paraprak mbi parimin e laicizmit të shtetit

Etimologjia e termit *laicizëm* (nga greqishtia *laikós*) do të thotë popull, çka nënkupton që në moment të parë laiku ishte një joklerik dhe termi tregonte thjesht anëtarësimin social të një individi. Në një moment të dytë shohim se si kjo fjalë vendosi kufijtë midis pushtetit shtetëror dhe atij shpirtëror, kurse sot kufijtë janë shtyrë deri tek pretendimet e ndërgjegjes, duke e kthyer atë në një “fortesë” për kundërshtuesit për shkak të saj, sepse në fund të fundit, ashtu siç evidenton edhe Rawls, liritë kanë prioritet (1).

Nga gjeneza parimi i laicizmit paraqitet mjaft kompleks, shumë kanë qenë momentet historike që kanë kontribuar për t’i dhënë atij formën moderne që paraqet sot (2). Por, “*ashtu si shumica e parimeve përbërëse të modernitetit, edhe ai i shekullarizmit është një parim në krizë të vazhdueshme, për shkak sepse është vazhdimisht në kërkim të një përkufizimi më adekuat*” (3).

Në këtë kuptim, duhet të nisemi nga një konkluzion paraprak që ky parim ka evoluar në kohë,

duke e bërë kamaleontik dhe eteromorf. Në shtete të ndryshme ai paraqitet me fytyra të ndryshme, kjo për shkak të kushteve sociale, kulturore dhe politike. Si rrjedhojë, edhe në Shqipëri ai shfaqet me trajta krejt origjinale, rezultat i shoqërisë multifetare dhe kushteve sociale e politike të vendit. Në këtë kontekst, duket e nevojshme një analizë e evoluimit që ky parim ka pasur në pak më shumë se 100 vite shtet, pasi ai ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në bashkëjetesën fetare të shoqërisë shqiptare, por edhe në ndërtimin e shtetit, sepse në fund të fundit, ashtu si Hegeli thekson, shteti është materializimi i një ideje absolute dhe i vetmi që mund të realizojë përsosmërinë e shpirtit njerëzor (4) sepse shteti është “*Hyrja e Perëndisë në botë*” (5). Në këtë kuptim, firmëtarët e pavarësisë së Shqipërisë kanë ditur të kuptojnë rëndësinë që besimi fetar kishte për formimin e shtetit të ri dhe rreziku që mund t’i vinte pikërisht nga feja.

2. Laicizmi i Shqipërisë nga Deklarata e Pavarësisë tek Statuti Themeltar i Mbretnisë

Me rënien e Perandorisë Osmane, Shqipëria shpall pavarësinë në 1912, çka nënkupton që nga ky moment shteti i ri duhet të shkëputte çdo lidhje me portën e shenjtë, në mënyrë që ky akt të merrte vlerë të plotë juridike.

Por vendi që para sundimit kishte qenë i krishtere, në afro 5 shekuj kishte humbur identitetin e tij fetar dhe në momentin më të rëndësishëm të shtet-formimit, paraqitej me katër komunitete fetare, ku mbizoteronte ai musliman që në vetevete ishte i ndarë mes suniteve dhe sufi bektashive (6). Jo pa motiv studiuesit e quajnë këtë periudhë si shekujt e errët (7). Po të kemi parasysh faktin që besimi fetar është element identifikues i një kombi, kjo shumëllojshmëri besimesh në Shqipëri përbënte vërtet një kërcënim për shtetin e ri shqiptar, i cili kërkonte të ngrihej në bazë kombëtare. Akti i pavarësisë deklaronte që Shqipëria është e ndarë, e lire dhe e pavaruar. Nga një lexim i kujdesshëm i këtyre pak fjalëve del në pah një lloj parimi i laicizmit i nënkuptuar, pasi deklarimi i ndarjes nga Perandoria Otomane solli si pasojë edhe shkëputjen nga ligjet e saj të influencuara nga dogmat kuranore. Gjithashtu, edhe me termin *pavarësi* mund të nënkuptojmë një pavarësi nga fuqitë e ndryshme, qofshin ato shtetërore apo shpirtërore. Në këtë kontekst, Deklarata e Pavarësisë e vitit 1912, që në momentin e parë, edhe pse në mënyrë implicite, pasqyron parashikimin e parimit të laicizmit në Shqipërinë e ndarë dhe të pavarur.

Ndërkaq, mund të themi që ishte pikërisht Statuti i Organik i vitit 1914 akti që në themelet e shtetit shqiptar e në mënyrë të shprehur, vendosi parimin e laicizmit. Veç të tjerash ky Statut kishte një fuqi juridike *erga omnes*, për këtë arsye edhe parimi i laicizimit duhej respektuar nga të gjitha institucionet e kohës.

Në nenin 32 të Statutit Organik sanksionohej: “*Shqipëria nuk ka fe shtetërore*”, gjithashtu kjo dispozite parashikonte edhe se “*Liria dhe ushtrimi publik i të gjitha kulteve janë të siguruara. Në asnjë pjesë të principatës shqiptare, ndryshimi në fe nuk mund t’i vihet asnjëri si shkak për të përjashtuar ose për ta cilësuar si të paafte përsa i përket gëzimit të të drejtave civile e politike, pranimit në punë shtetërore, në funksione ose ndere ose përsa i përket ushtrimit të profesioneve dhe aktiviteteve të ndryshme*”.

Siç është e njohur, ky Statut ishte një akt që ishte hartuar nga 5 fuqitë e mëdha të kohës, të cilat në hartimin e tij kishin në vëmendje edhe kompozimin fetar në Shqipëri, pasi afro 70% e popullit pas gati pesë shekujsh sundimi osman i përkiste besimit fetar mysliman. Në vendet e Ballkanit këtë konvertim të madh në fenë muslimane e kishte pasur Shqipëria dhe Bosnja, pasi vendet e tjera ballkanike të cilat kishin qenë nën sundimin osman, kishin munduar të mbanin identitetin e tyre fetar.

Kartat themelore të shtetit shqiptar dhe rëndësia që ato i kanë dhënë parimit të laicizmit

Gjithashtu, në Statut parashikohej një kapitull i veçantë mbi kultet në Shqipëri dhe që në dispozitat e para njihej personaliteti juridik i bashkësive fetare. Pikërisht në kapitullin XI, neni 170 sanksiononte se *“Të gjitha komunitetet fetare shqiptare ekzistuese njihen (nga Shteti). Ky parim zbatohet edhe për sektet e ndryshme myslimane. Asnjë pengesë nuk duhet të nxirret për organizimin hierarkik të komuniteteve të ndryshme e as për marrëdhëniet që këto mund të kenë në çështje të dogmës fetare, me kryetarët e tyre shpirtërorë më të lartë”*.

Në këtë nen, si edhe në nenet vijuese, përforcohet parimi i laicizmit të shtetit, duke e kthyer atë në një realitet të paevitueshëm për shtetin shqiptar. Më qartë, neni 171 parashikonte se komunitetet fetare në Shqipëri do të ruajnë pasuritë e tyre, kurse ai 174 shprehte: *“Në rast se formohen komunitete fetare të reja të kulteve të ndryshme, shteti rezervon të drejtën t’i njohë dhe të përcaktojë të drejtat e tyre”*. Dy nene të tjera mjaft të rëndësishme për interpretimin e parimit në fjalë ishin ato 176 dhe 177, pasi i pari deklaronte se *“Rregullimi i marrëdhënieve midis kishave ekzistuese në Shqipëri dhe kryetarëve të tyre shpirtërorë më të lartë do të jetë objekt i marrëveshjeve të posaçme që do të lidhen midis qeverisë shqiptare dhe këtyre krerëve”*, kurse tjetri pohonte se *“Shteti duhet të marrë masa për mbajtjen e të gjitha kulteve të njohura, si dhe të klerit duke caktuar për këtë qëllim shumën që do të gjykojë të nevojshme në buxhetin e përgjithshëm shtetëror; do të ketë parasysht edhe pasuritë e patundshme që kanë aktualisht këto kulte”*.

Statuti Organik i Shqipërisë qëndroi në fuqi shumë pak kohë, pasi Mbreti (Princ Wied), që bashkë me Statutin i ishin dhënë Shqipërisë nga fuqitë e mëdha, braktisi fronin në fillimin e Luftës së Parë Botërore.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, dhe pas rikompozimit të fuqive të mëdhasi pasojë e kësaj lufte, Shqipëria shpëtoi pavarësinë e saj, por i duhej të krijonte një klasë qeverisje me bazë kombëtare e për rrjedhojë, edhe normat juridike mbi të cilat kjo klasë duhet të qeveriste duhej të krijoheshin duke respektuar sovranitetin e shtetit shqiptar. Kështu, në vitin 1920, u mbajt Kongresi Kombëtar i Lushnjës, i cili në punimet e tij, miratoi atë që do të ishte kushtetuta e parë e hartuar nga shqiptarët për shtetin shqiptar ose ndryshe *Bazat e Kanunores së Këshillës së Naltë*. Në të vërtetë ky akt ishte i paplotë dhe përveçse sanksionoi formën e qeverisjes, nuk u ndal tek elemente të tjera, siç ishte parimi i laicizmit të shtetit. Vetëm me zgjerimin e kanunores, që u votua në vitin 1922, e njohur ndryshe si Statuti i zgjeruar i Lushnjës, në Shqipëri hyri përsëri në fuqi parimi i ndarjes së pushteteve (8). Ky Statut parashikonte në nenin 93 që në Shqipëri nuk kishte fe zyrtare dhe se *“Të gjitha fjet e besimet janë të nderueme dhe lirija e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre është e shigurueme. Feja nuk mund të formojë pengime juridike me asnjë mënyrë. Fet e besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike”*.

Tre vite më pas hyri në fuqi dekreti i qeverisë së Ahmet Zogut që parashikonte njohjen e personalitetit juridik për bashkësitë fetare (9), ky i fundit parashikonte në nenin 2 se *“Çdo degë e Myslimanizmës si Synnizma, Bektashizma, Rufaizma, Halvetizma, Kadirizma, Sadizma e tjerat, ashtu dhe çdo degë e Krishtenizmës, si Katolikizma, Orthodhokizma, Protestanizma si edhe të gjitha degat e çdo feje tjetër, mund të organizohet në një shoqjat fetare indipendente njana prej tjetrës”* (10). Gjithashtu, në nenin 1 të këtij dekreti njihej dhe përforcohej liria e ndërgjegjes.

Në vitin 1928, nën mbretërinë e mbretit të shqiptarëve, hyn në fuqi Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare i cili u bazua në të njëjtën frymë laicizmi të parashikur në Statutin e zgjeruar të Lushnjës. Sovrani gjithashtu e interpretoi me një frymë perëndimore këtë parim dhe mori disa iniciativa qeveritare për modernizimin e Shqipërisë, të cilat krijuan debat të thellë jo vetëm në shoqërinë civile, por edhe ndër bashkësitë fetare të pranishme në vend. Në këtë pikë vlen të përmendet

ndalimi i ferexhesë dhe i vellos islame, për të arritur deri te mbyllja e shkollave me karakter fetar, masë kjo që u tërhoq në një moment të dytë nën presionin e bashkësisë katolike dhe të ndërkombëtarëve.

Në nenin 5 të këtij statuti sanksionohej: “*Shteti Shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë e besimet janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe/o praktikimit të jashtëm të tyre është e siguruar. Feja nuk mund të formojë pengesa juridike në asnjë mënyë. Fetë dhe besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike*”.

Ky akt themelor ishte në fuqi deri në bashkimin midis Shqipërisë dhe Italisë (1939-1943) (11). Por pavarësisht se “kujdesatri” kishte si fe zyrtare atë katolike, në Shqipërinë multifetare njihje dhe respektonte të gjitha bashkësitë fetare të këtij vëndi. Në këtë logjikë Statuti Themeltar i Mbretënisë së Shqipërisë parashikonte në nenin 4 se “*Të gjitha fetë janë të nderume. Ushtrimi i lirë i kultit edhe praktikimit të jashtëm është i siguruem, në përshtatje me ligjë*”.

Nga kjo analizë rezulton se nga pavarësia e shpallur në vitin 1912, aktet themelore të shtetit shqiptar, edhe ato otriate, parashikonin parimin e laicizmit të shtetit i cili pushoi së ekzistuari me ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste.

3. Rrugëtimi i Shqipërisë nga shtet laik në shtet ateist deri tek parimi i laicizmit dhe neutralitetit të ditëve të sotme

Me ardhjen në pushtet të Partisë Komuniste Shqiptare, shohim një fushatë antiklerikale, por në fakt Statuti i Republikës Popullore Shqiptare i vitit 1946 parashikonte në nenin 16 që kisha ishte e ndarë nga feja. Ky parim afirmohej me të njëjtën formulë edhe në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës Popullore të vitit 1950 ku parashikohej se “*Të gjithë shtetasvet u garantohet liria e ndërgjegjës dhe e besimit. Kisha është e ndarë nga Shteti. Komunitetet fetare janë të lira në çështjet e tyre të besimit si edhe në ushtrimin dhe praktikimin e jashtëm të tyre. Ndalohet që Kisha dhe Feja të shpërdoren për qëllime politike. Gjithashtu ndalohen organizatat politike me bazë fetare. Shteti munt të ndihmojë materialisht komunitetet fetare*” (12).

Vihet re se pavarësisht që kushtetuta parashikonte lirinë e besimit fetar, u ndërmorën një sërë masash antiklerikale dhe vetëm me Kushtetutën Socialiste të Republikës së Shqipërisë të vitit 1976 shteti shqiptar u kthye nga një shtet laik, ndonëse nuk respektohej parimi i laicizmit, në një shtet ateist aktiv (13).

Kushtetuta e ‘76 sanksiononte shprehimisht në benin 37 se “*Shteti nuk njuh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botkuptimin materialist shkencor*”.

Kjo fryme ateiste shoqëroi shtetin dhe shoqërinë deri në fillim të viteve ‘90, ku vetëm me “*Ligjin mbi dispozitat kryesore Kushtetuese*” të vitit 1991, sanksionohej në nenin 7 të tij, që Shqipëria është vend laik dhe që shteti njuh lirinë e besimit fetar dhe krijon kushtet për ushtrimin e saj.

Kjo “kushtetute tranzitore” shoqëroi Shqipërinë përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit dhe vetëm në vitin 1998 u adoptua kushtetuta e re e konfirmuar nga populli nëpërmjet një referendumi pas votimit të saj në Parlamentin Shqiptar (14).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon në brëndësi të saj jo vetëm parimin e laicizmit të shtetit, por edhe atë të neutralitetit. Më saktësisht, në nenin 10 kjo kushtetutë shpall se: “*Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. Shteti është asnjë në çështjet e besimit e të ndërgjegjës dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. Shteti njuh barazinë e bashkësive fetare.*

Kartat themelore të shtetit shqiptar dhe rëndësia që ato i kanë dhënë parimit të laicizmit

Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve”(15).

Si konkluzion i këtij neni del se shteti shqiptar jo vetëm respekton parimin e laicizmit, por e konsideron veten neutral në çështjet e besimit fetar në vend. Gjithashtu, pavarësisht se feja myslimane përfaqëson maxhorancën e popullsisë në Shqipëri, shteti, respekton barazinë midis të gjitha komuniteteve dhe i njeh atyre personalitetin juridik. Pra, kushtetuta shqiptare e vitit 1998, duke pranuar lirinë e besimit fetar, ka parë të arsyeshme të specifikojë në mënyrë eksplicite parimin e laicizmi dhe të neutralitetit të shtetit në organizimin e kulteve fetare në Shqipëri. Në kohën kur divergjencat midis besimeve të ndryshme përbëjnë rrezik për mbarë shoqërinë botërore, sigurisht, kur ato manipulohen politikisht, shoqëria shqiptare e cila përbëhet nga besime të ndryshme më së miri i sanksionon dhe respekton këto parime duke e mënjanuar pushtetin shtetëror, për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të të gjitha kulteve.

Përfundime

Nga ky *excursus* historik rezulton se nga shpallja e pavarësisë në vitin 1912, shteti shqiptar i vetëdijshëm për realitetin historik post-osman; është munduar të mbajë ekuilibër dhe paqe sociale në një vend të ndarë mes katër bashkësive fetare historikisht ekzistuese në vend. Gjithashtu, del në pah se edhe nën kujdestarinë e vendeve të ndryshme, aktet themelore të shtetit kanë përmbajtur parimin e laicizmit të shtetit. Parimi i laicizmit në fazat që ka kaluar shteti shqiptar, në momente të ndryshme ka qenë thelbësor për vetë ekzistencën dhe mbijetesën e shtetit. Vetëm periudha komuniste eklipsoi këtë parim, i cili u rikthye më i fortë se kurrë pas viteve '90. Mohimi i tij nga pushteti komunist vjen pa diskutim, nga fakti që sistemi i cili u ngrit nga partia-shtet, arriti në pikën që të lejonte të vetmin besim, atë mbi ideologjinë komuniste. Sot kushtetuta shqiptare reflekton kulturën laike të ligjeve themelore që kanë karakterizuar vendin dhe ky parim real pasqyron një realitet ku katër bashkësi fetare bashkëjetojnë në paqe. Prandaj mund të themi që ai i Shqipërisë është një laicizëm real dhe funksional.

Referenca

1. Rawls, J., *Una teoria della giustizia*, Bologna, Feltrinelli, 1997, VI ed., f. 176 e në vazhdim.
2. Rimoli, F., Laicità, në *Enciclopedia Giuridica*, vol. XVIII, 1996, f. 1 e në vazhdim.
3. D'Agostino, F., *Il problema della laicità nell'esperienza contemporanea, ne Secularizacion y laicidad en la experiencia democratica moderna: jornada de estudio*, kuruar nga e J. Goti Ordenana, Libreria Carmelo, San Sebastian 1996, f. 31.
4. Hegel, G. W. F., *Enciclopedia delle scienze filosofiche in compendio*, 1821, përkth. it., kuruar nga B. Croce, Laterza, Bari, 1907.
5. Hegel, G.W.F., *Enciclopedia delle scienze filosofiche in compendio*, 1821, përkth. it., kuruar nga B. Croce, Laterza, Bari, 1907.
6. Clayer, N., *Zoti në vendin e mercedesëve. Komunitete fetare në shqipëri prej vitit 1990*, Paris, 2001; Clayer, N., *Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Karthala, Paris, 2007; Orlando, C., *L'aquila albanese alle prese con le correnti transnazionali. L'ABC di orgogli e pregiudizi*:

- Albania, Balcani e Comunità internazionale, Osservatorio sui Balcani, Roma, 2006.
7. Misha, P., *Invention of a nationalism: myth and amnesia, Albanian Identities. Myth and history*, në kujdesin e Fischer, B. J., në Schwanders-Sievers, London, C. Hurst & Co, 2002, f. 35-36.
 8. Morozzo Della Rocca, R., *Nazione e religione in Albania, 1920-1944*, Bologna, Il mulino, 1990, f. 88 e në vazhdim.
 9. Cimballo, G., *L'Islam plurale in Albania: modelli di relazione con lo Stato e pace religiosa Il ruolo del diritto statale e di quello religioso*, në *Stato, Chiese e pluralismo Confessionale*, Revista telematike (www.statoechiese.it), nr. 8/2014, cit., f. 3; Cimballo, G., *I rapporti tra lo Stato e le Comunità religiose in Albania*, në *Stato, Chiese e pluralismo confessionale*, Revista telematike, www.statoechiese.it, maggio 2010, cit., f. 9-10.
 10. Statuti Themeltar i Mretnisë Shqiptare, 1928.
 11. Rizzo's, G., *La Unione dell'Albania con l'Italia e lo Statuto del Regno d'Albania*, 1939; Sereni, A., P., *The Legal Status of Albania*, ne *The American Political Scienze Revieë*, 35, 2, 1941, f. 311-317.
 12. Dammacco, G., *Confessioni religiose e società nell'Albania contemporanea*, kuruar nga Coppola, R., në *Incontro tra canoni d'orient e d'occidente*, 2, Bari, Cacucci, 1994; Krh., Bociurkië, B., *I rapporti fra Stato e chiesa in URSS*, në *L'est*, n 1/1968.
 13. Ippolito, M. M., *Lo Stato che tentò di condannare a morte Dio: l'Albania comunista*, 2014, ne www.papalepapale.com.
 14. AA.VV., *L'attuazione della Costituzione albanese*, *Atti di seminario di Trieste 13-14 dicembre 1999* në *Quaderni del Dipartimento di scienze giuridiche*, Università degli Studi di Trieste, 4, 2001.
 15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.